

NDRYSHIMET E MODELIT TË FAMILJES PAS LUFTËS NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË SOCIOLOGJI

EKSPOZE E PUNIMIT TË TEMËS SË MASTERIT

NGA

EDONA SALIHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
PRISHTINË

DHJETOR, 2024

NDRYSHIMET E MODELIT TË FAMILJES PAS LUFTËS NË KOSOVË

Mentor: Prof. Dr. Gëzim Selaci

Kandidate: Edona Salihi

Punimi “Ndryshimet e modelit të familjes pas luftës në Kosovë” mbrohet nga Edona Salihi për marrjen e gradës Master i Arteve në Sociologji.

Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është të vë në pah dallimet mes familjes tradicionale dhe modeleve të sotme, duke shpërfaqur drejtimitet që kanë ndikuar në këto ndryshime.

Krahas qëllimit bazë të temës, dy objektiva apo synime janë:

1. Të analizohen drejtimitet e ndryshimeve nga periudha e viteve 60' e deri më sot, për të parë se si këto drejtime kanë ndikuar në ndryshimet në modelet e familjes në Kosovë në periudhën e pasluftës?
2. Sa ka ndikuar konteksti shoqëror në institucionin e familjes në vendin tonë?

Metodologjia

Për të realizuar këtë punim janë shtjelluar shembuj konkret duke përdorur analizën e diskursit. Gjithashtu janë realizuar 50 intervista të thella dhe të qëllimshme përmes pyetësorit. Janë përdorur edhe burime sekondare të publikimeve statistikore.

Hipoteza(t)

Hipoteza e hulumtimit është se institucioni i familjes ka ndryshuar nga struktura tradicionale, e bazuar në lidhje të forta dhe role të përcaktuara, drejt formave më të larmishme dhe nuk është përherë i pandryshueshëm siç shpesh mendohet.

Struktura

Punimi është e ndarë në dhjetë kapituj, që paraqiten shkurtimisht në vijim:

Kapitulli i parë: Në këtë kapitull është hyrja e punimit që flet në përgjithësi rreth institucionit të familjes tregohet interesi dhe origjinaliteti për temën.

Kapitulli i dytë: Paraqet qëllimin dhe objektivat dhe metodologjinë e përdorur gjatë gjithë punimit, ku jepen detaje mbi analizën e diskursit. Gjithashtu informata mbi intervistat e thella dhe të qëllimshme përmes pyetësorit, cilët kanë qenë pjesëmarrësit dhe si janë formuluar dhe analizuar intervistat.

Kapitulli i tretë: Paraqet historikun e zhvillimit sociologjik të familjes dhe përkufizimin e konceptit bazë të familjes në Kosovë.

Kapitulli i katërt: Në këtë kapitull është pjesa e teorisë rreth funksionit të familjes dhe ndryshimeve brenda saj. Paraqitja e familjes sipas Kanunit dhe ndikimi i tij në strukturën dhe organizimin në familje dhe në shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Kapitulli i pestë: Në këtë kapitull janë paraqitur koncepte mbi familjen e zgjeruar me theks në Kosovë. Janë paraqitur edhe rezultate nga pyetësi në raport me mënyrën e jetesës në familje të zgjeruar. Gjithashtu është paraqitur dhe analizuar filmi/dokumentar “113 anëtarë” dhe libri “Një amerikanë në Kosovë”.

Kapitulli i gjashtë: Në këtë kapitull janë paraqitur konceptet kryesore mbi martesën dhe analizimi në kornizat teorike. Është paraqitur poashtu edhe aspekti ligjor i rregullimit të martesës në Kosovë.

Kapitulli i shtatë: Në këtë kapitull është paraqitur procesi i punësimit të grave dhe ndikimi i saj në transformimet në strukturën familjare. Gjithashtu është analizuar edhe ndërlidhja me tranzicionin e lindshmërisë në Kosovë. Në këtë pjesë janë paraqitur edhe rezultatet nga përgjigjet e responentëve në pyetësor dhe janë përdorur edhe burime sekondare të publikimeve statistikore.

Kapitulli i tetë: Paraqet familjen si identitet social, në veçanti transformimet në modelin e familjes dhe strukturat e saj në periudhën e pasluftës në Kosovë dhe ndikimin në mënyrën se si individët ndërtojnë identitetin e tyre. Gjithashtu është paraqitur edhe bashkëjetesa si formë e jetesës në Cift sidomos viteve të fundit, shkurorëzimet dhe migrimet duke analizuar edhe rezultatet e përgjigjeve të pjesëmarrësve në pyetësor.

Kapitulli i nëntë: Në këtë kapitullin paraqiten ndryshimet në marrëdhëniet ndërfamiljare, duke përfshirë bazën ligjore si kusht të ndryshimeve në funksionin e familjes, prindërimi me baraza gjinore me theks në periudhën e pasluftës në Kosovë, për të vazhduar me paraqitjen e familjes në media. Në këtë pjesë është paraqitur dhe analizuar filmi/dokumentar ‘Dasmata dhe Pampersat’ që shperfaqë tranzicionin midis traditës dhe modernitetit. Gjithashtu është paraqitur me shembuj konkret dhe analizuar mënyra se si familja nga folësit publik në media shperfaqë një ndër vlerat tradicionale shqiptare.

Kapitulli i dhjetë: Në këtë kapitull është paraqitur përmbledhja/përfundimi nga të gjeturat e gjithë hulumtimit, duke e bashkangjitur edhe anaksin me pyetjet në pyetësor.